

243 PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për emrin/titullin konvencional për tekstet ligjore dhe fetare, të botuara nën juridiksionin e caktuar (zakonisht të shtetit) ose të kishës. Pikëqasjet e njësuara për tekstet ligjore dhe fetare zakonisht formohen me emrin e juridiksionit apo kishës dhe me titullin konvencional.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
243		Pikëqasja e njësuar – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare	nr
	a	<i>Elementi hyrës</i>	nr
	t	<i>Titulli konvencional</i>	nr
	9	<i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Nuk është i përcaktuar</i>
2		<i>Mënyra e shënimit të emrit</i>
	1	<i>emër i shënuar sipas shtetit ose emrave të tjerë gjeografik</i>
	2	<i>emër i shënuar sipas formës tjetër të emrit</i>

Vlera "1" e treguesit të dytë përdoret tek emrat gjeografik nën juridiksion.

Vlera "2" e treguesit të dytë përdoret te emrat e kishës.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfusha 9 është përshkruar në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

243a Elementi hyrës

Elementi hyrës i emrit të juridiksionit me të cilin janë botuar të gjitha ligjet dhe rregullat e tjera ligjore. Nënfusha është e detyrueshme.

243t Titulli konvencional

Forma e njësuar e titullit konvencional për tekstin që katalogohet.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit/titullit konvencional, që është përcaktuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 443 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE*
- 543 *PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE*
- 743 *PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE*

SHEMBUJ

1.

243	□1	aPortugal tLeis, decretos, etc.
-----	----	---------------------------------

2.

*

106	□□	a2
243	□1	aFranca tKushtetuta (1791)

3.

*

106	□□	a2
243	□1	aLubjana (Sllovenia ; bashkia) tStatutet